

VENDIM

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Ardian Dvorani	Kryesues
Medi Bici	Anëtar
Edmond Islamaj	Anëtar
Artan Broci	Anëtar
Admir Thanza	Anëtar

Mori në shqyrtim në seancën gjyqësore të datës 05.12.2017, çështjen që i përket:

PADITËS: BEHARE ÇIBUKAJ, në mungesë.

E PADITUR: DREJTORIA E SHËRBIMIT SPITALOR
TEPELENË, në mungesë.

OBJEKTI:

Kthim në punë. Detyrimin e të paditurit të më paguaj dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme pa shkaqe të justifikuara, për moszbatim të procedurës për largim nga puna, për mosrespektim të afatit të njoftimit si dhe shpërblim për vjetërsi në punë.

Baza Ligjore: Nenet 32 e 154 të K. Pr. Civile dhe 4, 7, 143, 144, 145, 146 e 155 të Kodit të Punës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me vendimin nr. 21-2013-531(283), date 26.03.2013, ka vendosur:

“Pranimin e pjesshëm të padisë.

Detyrimin e të paditurit Drejtoria e Shërbimit Spitalor Tepelenë t’i paguaj paditëses Behare Çibuku si dëmshpërblim për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara dhe shpërblim për vjetërsi në punë në masën e 16,5 pagave mujore.

Rrëzimin për përsa i përket kërkimeve të tjera në objektin e padisë.

Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditur.”

Gjykata e Apelit Gjyqësor Gjirokastrë me vendimin nr. 285 datë 22.05.2013, ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit civil nr. 531(283), date 22.05.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Kundër vendimit nr. 285 datë 22.05.2013 të Gjykatës së Apelit Gjyqësor me të cilin është lënë në fuqi vendimi nr. 21-2013-531(283), date 26.03.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka ushtruar rekurs Drejtoria e Shërbimit Spitalor Tepelenë, e cila kanë kërkuar: *“ndryshimin e vendimit nr. 285 datë 22.05.2013 të Gjykatës së Apelit Gjyqësor me të cilin*

është lënë në fuqi vendimi nr. 21-2013-531(283), date 26.03.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë”

V E N D O S I

Lënien në fuqi të vendimit nr. 285 datë 22.05.2013, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë

Tiranë, më 05.12.2017

**Nr. 11241-02081-00-2013 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2017 2368 i Vendimit (871)**

Dixhitalizuar dhe Perpunuar Qendra për Çështjet e Informimit Publik
www.infocip.org